

V E N D I M

Nr. 870, datë 30.12.2021

DT 07/01/2022

N 1 PRŌ

PËR

FINANCIMIN E PROJEKTIT "EKIPET SPORTIVE-2022"
NË KUADËR TË LËVIZJES OLIMPIKE SHQIPTARE
TË KOMITETIT OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR (KOKSH)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, pikat 1 e 2, dhe 15, të ligjit nr.79/2017, "Për sportin", të ndryshuar, të ligjit nr.9936 datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Financimin në masën 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë të projektit "Ekipet sportive 2022", në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH).
2. Fondi i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, transferohet në llogarinë e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), në bankën e nivelit të dytë/Raiffeisen Bank, sh.a, me numër llogarie 0050249325 dhe përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2021 për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, përkatësisht në llogarinë ekonomike 604 "Transferta të brendshme", në programin buxhetor 08140 "Zhvillimi i sportit".
3. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), brenda muajit janar 2022, të paraqesë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit projektin e detajuar dhe të miratuar nga Asambleja e KOKSH-it, duke identifikuar të gjitha aktivitetet/produktet e projektit, kohëzgjatjen e zbatimit të projektit, federatat dhe organizmat e tjerë përfitues nga projekti. Projekti duhet të jetë i kostuar me të gjithë produktet/zërat analitikë të shpenzimeve, në përputhje me klasifikimin ekonomik buxhetor të tyre.

4. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) raporton, periodikisht, mbi bazë katërmujore pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, mbi ecurinë e aktiviteteve/produkteve dhe realizimin financiar të projektit.
5. Ministria e Arsimit dhe Sportit cakton një grup pune për mbikëqyrjen e realizimit të projektit. Përbërja dhe detyrat e grupit të punës përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.
6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**MINISTRI I ARSIMIT
DHE SPORTIT**

EVIS KUSHI

